



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura V**  
**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**  
Mbledhja nr.78/2016  
Prishtinë, më 11.11.2016, në orën 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJAE PËRBASHKËT E KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,**  
**INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI/KUVENDI I REPUBLIKËS SË**  
**KOSOVËS DHE KOMISIONI PËR VEPRIMTARI PRODHUESE, TREGTI DHE**  
**MJEDIS/KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**Në mbledhje morën pjesë:** Muhamet Mustafa, kryetar, Glauk Konjufca, nënkryetar, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha - Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Rrustem Berisha, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, ndërsa Eduard Shalsi, kryetar, Genc Ruli, nënkryetar i Komisionit, Robert Bitri, Namik Koplaku, Besnik Baraj dhe Kozma Dashi, anëtarë të Komisionit për Veprimtari Prodhuese, Tregti dhe Mjedis.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Amir Kozmaqi – INDEP, Fjolla Uka – KDI dhe Etleva Malushaj –LVV.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Veton Raci.

**Mbledhjen e kryesuan: Muhamet Mustafa dhe Eduard Shalsi.**

**Në këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

1. Ecuria dhe bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve (Republika e Kosovës-Republika e Shqipërisë) në fushën e ekonomisë, me theks të veçantë për zbatimin e Marrëveshjeve dhe avancimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit.

**1. Ecuria dhe bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve (Republika e Kosovës-Republika e Shqipërisë) në fushën e ekonomisë, me theks të veçantë për zbatimin e Marrëveshjeve dhe avancimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit.**

**Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri,** i dëshiroi mirëseardhje Komisionit homolog të Kuvendit të Shqipërisë, dhe falënderoi për zemërsisht kolegun z. Eduard Shalsi. Ne patëm një vizitë të frytshme vitin e kaluar dhe bisedime të mira në këtë drejtim. Tash është rasti që t'i rikujtojmë disa nga çështjet që i kemi biseduar atëherë dhe të bisedojmë bashkërisht për bashkëpunimin midis dy komisioneve, por gjithmonë duke pasur parasysh një rol shumë të rëndësishëm që kemi si komisione për zhvillim ekonomik dhe për çështje të rëndësishme të ekonomisë në përgjithësi dhe bashkëpunimin e mirë që kemi midis dy vendeve tona, ta fuqizojmë edhe më shumë me idetë dhe me punën tonë të përditshme.

**Eduard Shalsi, kryetar i Komisionit për Veprimtari Prodhuese, Tregti dhe Mjedis,** falënderoi zotin Mustafa për ftesën dhe tha se për ne është gjithmonë kënaqësi të jemi në Kosovë dhe dyfishë kënaqësi që jemi në Parlamentin e Kosovës. Është më rëndësi të potencohet se komisioni juaj dhe komisioni ynë, po e bëjmë për herë të parë dhe po hedhim një hap të tillë, pra po i mbajmë mbledhjet e përbashkëta. Nga takimi i parë yni, gjatë një konference për energjinë jashtë vendit deri tek takimi që kemi bërë në Tiranë dhe ky i sotmi, kanë shtruar rrugën që të bashkëpunojmë dhe ta shtrijmë deh ta thellojmë bashkëpunimin tonë. Sigurisht që kur e iniciuam bashkërisht këtë punë, synimi i parë ishte të njiheshim më mirë dhe së dyti për t'u prezantuar punët e parlamenteve dhe komisioneve tona. Kemi sfida të ndryshme, por kemi edhe sfida të përbashkëta, theksoi Shalsi.

Në diskutim morën pjesë deputetët: **Raif Qela, Genc Ruli, Blerim Grainca, Robert Bitri, Besim Beqaj, Besnik Baraj, Sala Berisha – Shala, Kozma Dashi,** të dhëna në transkript pjesë e këtij procesverbali.

Pas debatit, u miratuan këto:

**Konkluzione**

1. Monitorimi i Marrëveshjeve qeveritare dhe të kërkohet llogari nga dy qeveritë për zbatimin e tyre;
2. Diskutimi i projekteve të përbashkëta;
3. Ngritja e çështjeve problemore, përfshi legjislacionin dhe burokracinë;
4. Bashkëpunimi i dhomave të tregtisë;
5. Shkëmbimi i kalendarit të punimeve të të dy komisioneve;

**Mbledhja përfundoi në orën 15:00.**

**E përgatiti:  
Stafi mbështetës i Komisionit**

**Kryetar i Komisionit  
Muhamet Mustafa**

*(Mbledhjen e kryeson kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa dhe Eduard Shalsi)*

KRYETARI: Të nderuar kolegë,

Më lejoni që të fillojmë me këtë diskutim të përbashkët midis dy komisioneve,

Më lejoni që të falënderoj për zemërsisht kolegun tim Eduard Shalsi dhe anëtarët e komisionit përkatës të Kuvendit të Shqipërisë që na kanë nderuar me vizitën tonë vitin e kaluar. Ne patëm një vizitë të frytshme dhe bisedime të mira në këtë anë. Tash është rasti që t'i rikujtojmë disa nga çështjet që i kemi biseduar atëherë dhe të bisedojmë bashkërisht për bashkëpunimin midis dy komisioneve por gjithmonë duke pasur parasysh një rol shumë të rëndësishëm që kemi si komisione për Zhvillim ekonomik dhe për çështje të rëndësishme të ekonomisë që në përgjithësi bashkëpunimin e mirë që kemi midis dy vendeve midis Shqipërisë dhe Kosovës ta fuqizojmë edhe më shumë me idetë tona dhe me punën tonë të përditshme.

Këtu po thuaj se kemi në tërësi Komisionin tonë, Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, këtu e kemi kolegun tim Glauk Konjufca që është nënkryetar i Komisionit nga Lëvizja "Vetëvendosje", kolegun Besim Beqaj që e njihni të gjithë, kolegun Raif Qela të dytë nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike edhe pse Raifi është i Lëvizjes për Bashkim mandej është deputeti Fatmir Rexhepi nga LDK-ja, deputeti Blerim Grainca nga LDK, deputeti Rrustem Berisha nga AAK-ja, deputeti Enver Hoti nga NISMA dhe deputeten Duda Bale nga Grupi "6+", kjo është përbërja jonë këtu nuk i kemi vetëm përfaqësuesit e komunitetit serbë tjerët po më duken që jemi të gjithë, ata momentalisht janë duke bojkotuar punën e Kuvendit por shpresojmë që edhe ky problem do të tejkalohet pretekst ishte Ligji për "Trepçën" ne u morëm vesh që gjatë drekës të ju njoftojmë pak më gjatë për atë çështje.

Ju faleminderit edhe një herë për vizitën, unë mendoj që pas njohjes reciproke që i kemi edhe emrat paka shumë por ndoshta si shohim prezantimin që do të kemi të delegacionit të japim një pasqyrë të përgjithshme të situatës ekonomike dhe të bashkëpunimit dhe të shohim më tutje si do të ecë.

EDUARD SHALSI: I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Për ne është gjithmonë kënaqësi të jemi në Kosovë dyfishë kënaqësi që jemi në Parlamentin e Kosovës dhe jam shumë i gëzuar që tashmë kemi filluar të hedhim një hap të them të rëndësishëm në komunikimin mes dy parlamenteve.

Në dijeninë time ish komisioni juaj dhe komisioni ynë që po e bëjmë për herë të parë dhe po hedhim një hap të tillë. Mbajë në mend nga takimi i parë i yni gjatë një konference për energjinë jashtë deri tek takimi që kemi bërë në Tiranë dhe ky i sotmi kanë shtruar rrugën që të bashkëpunojmë dhe ta shtrijmë bashkëpunimin akoma edhe më thellë.

Sigurisht që kur e iniciuam bashkërisht këtë punë synimi i parë ishte të njiheshim më mirë me njëri tjetrin. Disa prej nesh njihemi nëpërmjet televizorit ky ishte një moment i mirë për të njohur dhe për tu prezantuar më afër me njëri tjetrin.

Së dyti për t'u prezantuar punë e parlamenteve dhe komisioneve tona.

Sigurisht që kemi sfida të ndryshme por kemi edhe sfida të përbashkëta.

Dhe, njohja me punën reciproke të komisioneve do të na bënte akoma edhe më të lehtë edhe gjetjen e zgjidhjeve për sfidat që besoj në disa raste i kemi edhe të përbashkëta.

Unë do të doja të prezantoja fillimisht edhe grupin e deputetëve në krahë të majtë i pari në radhë është zoti Besnik Baraj, anëtar i Partisë Socialiste, me begrandë akademik profesor në Universitetin e Tiranës, pra ka qenë profesor edhe në Barcelonë dhe në Brazil. Zoti Robert Bitri, sekretar i Komisionit quhet veprimtari prodhuese Tregtisë dhe Mjedisit e me ... gjatë por akoma edhe më të shumta i ka funksionet duke pasur parasysh se sa ministri i mbulon.

Zoti Bitri edhe ai me eksperiencë të gjatë politike ka punuar në Pushtetin Vendor dhe ka mbuluar funksionet e rëndësishme, është anëtar i Lëvizjes Socialiste për Integrim.

I treti në radhë por për mua është shumë lehtë i prezentueshëm sepse në fakt nuk ka nevojë për prezantim është personi që e njohim mirë në Kosovë Genc Ruli, ish ministër i Financave, pastaj i Ekonomisë, i Bujqësisë, Partisë Demokratike nënkryetar i Komisionit me shumë eksperiencë politike por jo vetëm ka edhe një periudhë shkëputje nga politika dhe përfshirje në themi në shoqërinë civile apo në grupin e ekspertëve por oponent i hershëm por bashkëpunojë i vyer në komision. Edhe Genci vjen nga bota akademike përpara se të përfshihej në politikë.

Po ashtu në vijim të Gencit nga bota akademike vjen edhe zoti Nami Kopluku, deputet i Shkodrës, anëtar i Partisë Socialiste.

Në fakt unë jam më me pak eksperiencë politike nga të gjithë anëtarët e Komisionit. I fundit por jam nga .. është zoti Kozma Dashi, që na kishin ngatërruar emrin. Ky është një këngëtar i famshëm në Tiranë po zakonisht e ngatërrojnë atë me Kozmajin jo Kozmain me atë, inxhinier me profesion. Teksa vinim këtu na tregonte eksperiencat e tij të gjata në ndërtimin e hidrocentraleve bilomedrin, anëtarë i Partisë Demokratike, njëri me eksperiencë edhe në biznesin privat, deputet i qarkut të Fierit... që pjesë të delegacionit nuk kemi asnjë zonjë dhe ku shoh dy zonjat zonja që sapo erdhi për shkak të agjendave por edhe disa të papriturave ne kishim fiksuar këtë takim dhe nuk donim ta shtynim por një pjesë e kolegeve tona e kishin të pamundur të vinte në komision por edhe një herë shprehë kënaqësinë që jemi në Parlamentin e Kosovës mes miqve tanë dhe kemi hapur udhën po themi të një bashkëpunimi të cilin nuk mbetet gjë tjetër vetëm se ta përmirësojmë dhe jemi nikoshient që rruga do të jetë e gjatë por ne së paku e kemi futur makinën parlamentare tonën dhe të tuajën në po them në drejtimin e duhur por kjo nuk ka të bëjë me sloganin tonë zotit Rulit të 2015, thjeshtë them që është kënaqësi dhe shpresojmë që ta vijojmë këtë punë që kemi nisur.

**KRYETARI:** Faleminderit shumë, Eduard!

Më lejoni në pika të shkurta të ju njoftoj me situatën ekonomike që e kemi në Kosovë prandaj kalojmë në gjëra më konkrete.

Ne kemi një rritje ekonomike diku rreth 4% të GDP dhe Shqipëria ka diku përafërsisht 3 më duke apo jo kohëve të fundit. Jemi dy vend që në rajon pak rriten më shpejt, por sa i përket

Kosovës kjo është një rritje e pamjaftueshme për t'i përballua problemet që i kemi kryesisht me punësimin dhe problemet me bilancin negativ tregtarë dhe këto dy probleme përkundër një rritje ekonomike që kemi pasur ... mirëpo ka mbet po thuaj se në nivel të njëjtë edhe punësimi edhe deficitin tregtar pa përmirësime të ndjeshme tërë këto vite.

Prandaj, problemi i zhvillimit ekonomike, rritjes ekonomike, problemi i investimeve për Kosovës është jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe pikërisht nëse mund të fuqizojmë bashkërisht këto dy çështje paka shumë janë problem megjithëse shifrat e papunësisë në Shqipëri nuk dalin aq të larta sikurse tek ne, por megjithatë në përgjithësi mendoj se kemi shumë punë për të bërë.

Ne tash jemi sikurse edhe ju me buxhetin duke u marrë me buxhetin është një diskutim besoj përmbajtësorë, diskut i gjallë në parlament dhe mbrëmë e kemi fillua këtë diskutim me profesor Beqaj në RTK por besoj se do ta vazhdojmë edhe në Kuvend sidomos në Komisionin për Buxhet, ne merremi me buxhetin në disa segmente që kanë të bëjnë me fushëveprimet e Komisionit tonë, po buxheti sivjet po mbëri mbi dy miliardë euro rreth dy miliardë euro ka diku rreth 30% të GDP nga ana e shpenzimeve diku 27% nga ana e të ardhurave buxhetore nga taksat edhe të ardhurat tjera origjinale, këta tre poena përmbushen me emitim të letrave me vlerë dhe me disa mjete që llogaritet t'i kem nga fondi i privatizimit si dhe .. të investimeve që do të thotë financim i disa projekteve nëpërmjet huave nga institucionet financiare ndërkombëtare. Nuk është pa sfida por në përgjithësi ne kemi pasur një stabilitet makro ekonomik stabilitet financiar, kemi një pjesëmarrje të ulët të borxhit në GDP-i tash diku është rreth 10% edhe pse ka tendenca të rritjes.

Ne kemi një hapësirë të huamarrjeve nga jashtë e kredive nga jashtë mjaftë të mirë, mirëpo kemi shtruar nevojën që të jemi shumë të kujdesshëm ku do t'i investojmë ato para për arsye se edhe një pjesëmarrje e borxhit 20% në qoftë se është investua në projekte të këqija mund të krijoj probleme serioze. Në këtë drejtim problemet janë me investime, ne kemi ende një nivel të pamjaftueshëm të investimeve diku 25% të GDP-së dhe pikërisht këtu qëndron ndoshta një nga arsyet sepse ne nuk kemi mjaft vende të reja të punës do të duhej të hapnim diku nja 40% a më shumë vende të punës se sa që hapim për të përballuar kontingjentet që hyjnë në tregun e punës. Natyrisht që situata duket më e përmirësuar në disa segmente sa i përket rritjes ekonomike me një ngece të eksportit dhe investimet.

Tash, të them disa fjalë rreth bashkëpunimit në përgjithësi kur i kemi shikua shifrat e bashkëpunimit tregtarë të Shqipërisë dhe të Kosovës shohim se ka një rritje të ndjeshme sidomos nga viti 2010 deri në vitin 2015 qarkullimi në dy anët është dyfishua domethënë ka qenë rreth 100 milionë euro tash është 200 milionë edhe pse natyrisht këto shifra janë shumë më të vogla se sa potenciali që kemi.

Nëse hyjmë në strukturën e analizës të situatës që kemi domethënë eksporti i Kosovës në këtë periudhë pra për këto pesë vite është rritë nga 31 milionë në 40 milionë, kurse importi nga Shqipëria përkatësisht eksporti i Shqipërisë në Kosovë nga 70 milionë në 151 milionë. Domethënë situata nuk duket e mirë në vitin 2015 dhe 2016 sa i përket eksportit Kosovë Shqipëri kemi një rënie ..5% dhe në 2015 dhe një rënie 2.7% mbi atë rënie e kaluar në vitin 2016 për 9 muaj domethënë deri në fund të shtatorit.

Natyrisht që këtu ka bukur shumë çështje që mund të kenë ndikuar dhe mund të ndikojnë. Në përgjithësi thash se eksporti i Kosovës për kah vlera ka stagnua për arsye se një nga eksportuesit kryesor të Kosovës është Ferronikli edhe aty kemi pasur një rënie të çmimeve kështu që pak është shprehë edhe në vlerën e përgjithshme të eksportit, por në përgjithësi nëse e shohim strukturën e mallrave kryesore që këmbehen domethënë ne kryesisht po eksportojmë domethënë mbetje ferrike domethënë mbeturina të hekurit lingota, miëë gruri dhe mill meslini, tuba tubacione profile të zgavruara, mbetje kthimi nga alumini dhe birr e bërë nga malti. Këto janë kategoritë kryesore të eksporteve të Kosovës në Shqipëri.

Kurse importojmë domethënë shufra, dizga çeliku, sende të faktuara, vajra të naftës, çimento, ... bitumen 10 milionë domethënë edhe cehrore dhe koncentre të hekurit sigurisht ne importojmë edhe gjëra ushqimore dhe pije shumë por këto janë pesë produkte që janë në vendin e parë.

Në përgjithësi unë mendoj se nuk janë shfrytëzua mundësitë e bashkëpunimit tregtarë, këmbimi tregtarë ka shumë hapësira që të rriten në dy anët dhe nde duhet të punojmë bashkërisht në atë drejtim.

Ka disa pengesa, ka disa probleme që i theksojnë bizneset, asociacionet.

Unë nuk do të kisha fol sot për këto, ne i kemi ato të shënuara propozoj që do të ju japim juve me veti në mënyrë që ju t'i thirrni ndoshta institucionet përkatëse dhe shihni çka mund të bëni nga ana e parlamentit sepse ne sot ato nuk mund t'i zgjidhim më mirë mendoj që të flasim për projekte që mund të bëjmë në të ardhme projekte të reja.

Raif mos deshe tash me intervenua unë ende jam duke fol, po paraqitesh për fjalë, po të kam pa.

Kështu që unë po propozoj që sot të shkojmë më tepër kah projektet që do të inicionim gjërat që mund të bëjmë që t'i përmirësojmë këto gjëra për disa pengesa që i kemi marrë nga Oda Ekonomike, nga disa ministri. Ne do të ju japim një dosje ashtu qysh i kemi marrë ne dhe besoj që ju do t'i trajtoni, njëkohësisht po ju lusim edhe juve që të merrni të gjitha vërejtjet që keni nga bizneset, nga asociacionet, nga subjektet të caktuara në Shqipëri të na i dërgoni neve dhe do t'i thërrasim të gjithë ato institucione në raportim në mënyrë që të kalohen ato probleme. Kisha propozua kështu për të dy palët që të kemi këtë qasje.

Te energjia ne kemi fol shpesh me Eduardin, mendoj se ne kemi një shans shumë të mirë që të përmirësojmë situatën energjetike, i kemi resurset interkoneksioni është problem duhet të punojmë bashkë të dy shtetet që të evitojmë këtë bllokadën serbe dhe opstrukcionin e Serbisë lidhur me efektuimin e interkoneksionit sepse mos efektuimi e interkoneksionit ka ndikime në çmim, ka ndikime në furnizim .. janë të ndamë ekonomike në të dy vendet mendojmë që ne Serbisë do të ja bëjmë me dije që i kemi interesat ekonomike dhe ato duhet t'i mbrojmë krahas deklaratave që i kemi për zhvillimin e bashkëpunimit fqinjësorë në ato pika ku goditen interesat ekonomike, resurset tona, mendoj se duhet të jemi shumë të qartë. Kapacitetet energjetike mund të fuqizohen, mendoj se kish me qenë mirë që ne të kem diçka nga hidropotencialet në Shqipëri dhe ju nga termopotencialet tona dhe të iniciojmë një ndërlidhe shumë më të mirë të operatorëve.

Janë bërë studime që kanë tregua në qoftë se ndërlidhen dy operatorë çmimi del më i lirë edhe në Shqipëri edhe në Kosovës. ne mund të shkojmë në një nxitje të këtyre. Kolegu im Grainca e ka pasur një ide për një rafineri ... sepse nuk kemi dy vend por ajo është një projekt që është më tepër ide që duhet ta kem të përbashkët.

Gjithashtu edhe projekti TAP është diçka që është strategjik për dy vendet edhe të bashkëpunojmë sigurisht në atë drejtim.

Në infrastrukturë mos me zgjatë më shumë, rruga e kombit ka krijuar një gjë politike të re dhe një gjeografi të re por derisa nuk lidhet me Nishin, kështu që kishim disa diskutime të tepruar më duket që nuk janë lexua mirë disa sende por në përgjithësi interesi ... ai ishte një ... për me i mbështetë projektet rajonale dhe u interpretua ndryshe këtu por mendoj që ne kemi interes që të nxitet të kryhet kjo rrugë në drejtim të Nishit sepse vetëm ashtu vizibiliteti i kësaj rruge bie në shprehje edhe fuqizimi i .. të Durrësit por edhe resurseve tona.

Natyrisht që duhet të shohim, ne jemi keq me hekurudhat besoj që edhe Shqipëria nuk është mirë, po na një lidhje të mirë hekurudhore kjo është e kushtueshme është e rëndësishme por ne duhet të bëjmë të llojme që ta krijojmë atë hekurudhorë në qoftë se duhet një bashkëpunim me partneritet për arsye se edhe ajo faktorizon resurset tona dhe faktorizon dy vendet.

Investimet e përbashkëta janë në nivel të ulët, krejt çka investohen janë patundshmëritë tash për tash, shumica e investimeve janë patundshmëri në të dy anët. Mendoj se duhet të shohim se si të krijohen investime në ekonomi.

Çështja shumë me rëndësi është, ne e kemi mirëpritur besoj të ky kuvendet e kanë mirëpritur shumë mbledhjet e përbashkëta të qeverive, nga ato mbledhje të përbashkëta kanë dal një mori marrëveshje të cilat janë shumë të rëndësishme por në përgjithësi ngecë mekanizmi i koordinimit, të bashkërenditjes dhe zbatimit të këtyre marrëveshjeve.

Ndoshta rolin e kemi bisedua me kolegun Shansi që tek komisionet kuvendore dhe kuvendet të marrin një rol të monitorimit të zbatimit të këtyre marrëveshjeve sepse vetëm mos zbatimi i tyre domethënë reflektohet edhe në shifra që nganjëherë po i përmendim të dy anët edhe me vëllimin tregtar por edhe në të tjerat projekte.

Ne kemi bisedua shumë që të krijojmë një bashkëpunim edhe më të ngushtë midis dy komisioneve, do të kemi agjendat e komisioneve t'i këmbëjmë ligjet, njëra nga çështjet që e kemi përmend këtu është unifikimi i legjislacionit, ajo është një punë shumë e madhe bile ligjet që i biem tash e tutje t'i këmbëjmë përvojat dhe të jenë sa më të afërta dhe mos të na pengojnë diskutimin dhe mandej të kalojmë t'i identifikojmë ligjet tanimë të aprovuara në mënyrë që t'i përmirësojmë aty ku duhet dhe pikërisht kolegu ... që e ka pas propozimin e shkëlqyeshëm për këtë, mendoj se ne duhet të...

Me përgjegjësi mendoj se bashkëpunimi ekonomik duhet të fuqizohet, për arsye se faktorizimi i dy vendeve, faktorizimi i kombit tonë në rajon ndërlidhet shumë ngushtë me këtë punë. Situatat e reja gjeopolitike na tregojnë se ne duhet të punojmë bashkë dhe të fuqizojmë. E kemi një situatë ku duhet të krijojmë ndoshta një hapësirë unike ekonomike saktë do të jetë të krijohet

menjëherë, por çdo muaj, çdo vit bëjmë hapa të rëndësishëm në atë drejtim rreth unionit ... rreth hapësirës ekonomike, sepse një treg prej 6-7 milionëve është krejt diçka tjetër prej një tregu 2-3 milionë. Kështu që janë edhe çështje tjera, mendoj se kemi shumë ..., kemi diskutime të pavend lidhur me identitetet, të cilat janë pengesë.

Ne këtu shumica prej nesh nuk i ka mirëprit ato diskutime, natyrisht që kemi analistë që kemi që i diskutojnë, por ne mendojmë se nuk ka nevojë të diskutohen, të sforcohen diskutimet tilla. Në vend të tyre ne duhet të merremi me hapjes e perspektivave të bashkëpunimit në tërësi dhe kjo është qëllimi i takimit që e kemi pas në Tiranë, ky është qëllimi i takimit që kemi sot dhe unë ju falënderoj për zemërsisht për qëndrimin tuaj shumë konstruktiv që të ecim në këtë agjendë.

Kaq kisha sa për fillim.

**EDUARD SHALSI:** Faleminderit, kryetar!

Shumë shkurtë do shpjegoj një panoramë se ç'po ndodh në Shqipëri dhe pastaj do të ftoja edhe kolegët, edhe bashkarish që të përcaktonim një agjendë më konkrete të bashkëpunimit.

Në Shqipëri në fakt kemi marrë disa reforma, do të thoja tejet të vështira, disa ... po duke shpresuar që kishte ardhur koha që të ndërmerim disa hapa për të futur vendin në brazdë. Dhe, nëse do të përmendja disa prej tyre do të filloja me atë të energjisë. Ne pak më parë patëm edhe një takim me entet rregullatore të ujit dhe të energjisë së Kosovës dhe do të thoja që një nga sfidat tona më të mëdha ishte sektori i energjisë dhe të gjithë e dimë që pa një sektorë energjik të qëndrueshëm, të konsoliduar, ... mrekullia tjetër ekonomike do të ishte e pavlefshme.

Andaj e nisëm një reformë në sektorin e energjisë, pjesë e reformës ishte edhe lufta kundër informalitetit, do të jap një shifër Shqipëri kishim 50% të popullsisë që nuk paguante apo 50% e popullsisë që paguante edhe për ata që nuk paguante. Ndërkohë, falë bashkëpunimit me komunitetin e energjisë kemi iniciuar dhe miratuar disa ligje dhe rrugën nëpër të cilën do të eci ky sektorë. Pra, në sektorin e energjisë kishim një ndërhyrje.

Kemi bërë një reformë në pensione, skema e pensioneve që ekzistonte në Shqipëri kishte shndërruar si imediate domosdoshmërinë e ndryshimit, sepse ishte një skemë e cila shumë shpejt do të qonte në një themi falimentim, po them të mënyrës së pagesës. Së treti, Shqipëria e tranzicionit vuajti shumë nga ndërtimet kaotike. Pra, ndërtimet e paligjshme. Ishte e kuptueshme që në '91-shin Shqipëria ishte e papërgatitur për t'i dhënë drejtim apo për të orientuar mënyrën e ndërtimit. Nëse deri '90-ën i kishin ndaluar shqiptarët të lëvizin në mënyrë të lirshme jashtë por edhe brenda vendit, në '91-shin me ardhjen e demokracisë shqiptarët zgjodhën vetë të jetonin ku të jetonin, por shteti në atë kohë ishte i papërgatitur për të orientuar zhvillimin ndaj një nga problemet e mëdha ishte dhe mënyra e të ndërtuarit dhe mbi të gjitha mungesa e planifikimit.

Sot ne kemi hedhur le të themi që kemi vendosur në shina procesin e planifikimit si dhe procesin e legalizimit. Brenda këtyre viteve janë legalizuar numër i konsiderueshëm i godinave pa leje, të cilat ne besojmë që brenda një afati të shkurtër duhet të përfundojnë. Procesi i legalizimit në Shqipëri ka qenë proces pa afat, pra legalizim, legalizim. Vendoseshin afatet



bëhet fjala për rreth 350, sot mund të themi që kemi një statistikë, pa çka se statistikën në vendin tonë janë numra, të cilët duhen marrë me pikëpyetje dhe besoj është një sfidë e përbashkët ndërtimi i një baze të dhënash të saktë.

Por, pra sfida e planifikimit të territorit dhe legalizimit të ndërtimeve ka qenë një. Pastaj, ka reforma në disa sektorë, për shembull arsimit është një nga sektorët, të cilën e besojmë fort, kishte ardhur e domosdoshme nevojën për tu reformuar. Sivjet kemi për herë të parë, fillimin e aplikimit të reformës pavarësisht defekteve, besojmë se është gjëja dhe ishte gjëja e duhur për Shqipërinë.

Siç ju e thatë ne kemi një rritje mbi 3%, por ajo që është më e rëndësishme është që me ndihmën dhe asistencën e Fondit Monetar Ndërkombëtar kemi konsoliduar financat e Shqipërisë. U .. një pjesë e madhe të borxhit të akumuluar, por nga ana tjetër kemi hedh themele të qëndrueshme për të konsoliduar financat e Shqipërisë. Kemi edhe brenda muajit deri në mes të dhjetorit do të miratojmë buxhetin e vitit 2017, jemi të gëzuar sepse dje ne morëm progres raportin dhe veçantia e këtij progres raporti në fakt qëndron në faktin që sa herë kemi ndërrime të Qeverisë së Shqipërisë kemi progres raporte të vitit të parë shumë të mira. Viti i dytë vjen pastaj duke u zbehur, sepse nuk janë ose janë miratuar ligjet, por implementimi i ligjeve çalon dhe pastaj tek viti i tretë fillon.

Për herë të parë ne kemi një raport progresi, do të thojmë më të mirin që Shqipëria e ka pas. Çka na vlerëson, por edhe na inkurajon për të bërë më shumë. Ishte një lajm i jashtëzakonshëm për ne. Pati brenda raportit ne edhe si komision për sektorët që mbulojmë do të analizojmë më me detaje, por ishte një raport vlerësues inkurajues për të bërë më shumë.

Thashë që sfidat janë të shumta, por prioritetet, por një pikë e cila përpos reformave që përmendura është një domosdoshmëri, një kusht i jashtëzakonshëm dhe tashmë kriter për hapjen e negociatave me Shqipërinë që është reforma në drejtësi. Ju mund ta keni ndjekur nga televizioni, ne kemi miratuar në korrik ndryshimet kushtetuese, tashmë ka ngel vetëm një pikë kjo është ajo e ... që në progres raport theksohet qartë me zgjidhjen e këtij problemi, hapja e negociatave është plotësisht e realizueshme. Jemi koshient që pa një reformë në drejtësi të thellë, të plotë, të paanshme, jo politike, çdo lloj sektori tjetër do të afektohej.

Ndaj kemi përqendruar dhe një pjesë të madhe të konsiderueshme të energjive tona për ta bërë të mundur dhe tash jemi në finale me përjashtim të pikës së ... për të cilën presim një përgjigje nga Komisioni i Venecias. Nga ana tjetër, më duhet të bëjë dhe një shpjegim në fakt komisioni juaj quhet Komisioni për Zhvillimin Ekonomik, Tregtinë, Infrastrukturën dhe Industrinë, dhe kemi gjëra të përbashkëta një pjesë. Ne kemi një Komision Ekonomie në fakt në Parlament dhe ju këtu nuk e mbulon bujqësinë ishte një kemi takim mëvonshëm, komisioni jonë mbulon, quhet Veprimtaritë Prodhuese, Tregtia dhe Mjedisi, ndërkohë që transportet, energjinë, teknologjinë e informacionit, bujqësinë po ashtu edhe në fakt mbaj mend që kur fillova të merrem me komisionin intensivisht thashë ndoshta është e domosdoshme ta ndajmë komisionin se ka shumë përgjegjësi, por domethënë ti je i pari që thua ta ndajmë se zakonisht kemi ardhur këtu sepse i kanë dashur, por për çështjet e ekonomisë dhe për buxhetin, pavarësisht se ne do të marrim shqyrtim për 6 apo 7 ministri sa mbulojmë.

Komisioni i Ekonomisë është kryesori që mban peshën kryesore të diskutimeve, ndërkohë që ne mbulojmë sipas ministrive. Kemi caktuar si kalendar datën 1 dhjetor për diskutimin në parim, datën 15 dhjetor diskutimin nen për nen. ... një prezantim se çfarë jemi duke bërë në Shqipëri, ndërkohë thashë ky është takimi ynë i dytë. Kemi zhvilluar një takim në Tiranë dhe unë të paktën, pastaj gjithsecili nga kolegët është i lirë të komentojë, të sugjerojë. E kam parë trajektoren e bashkëpunimit nga kjo fazë, të cilën e ezaurojmë sot pra njohja dhe prezantimi nga afër.

Tek mënyra se si funksionojnë komisionet, pastaj tek marrëveshjet që qeveritë respektive kanë lidhur dhe për të cilat ne kemi gjithë mundësinë, detyrimin të kërkojmë shpjegime nga përfaqësuesit në çfarë niveli janë këto marrëveshje të lidhura. Pra, ka ngel në kuadrin e letrave apo janë implementuar. Nëse nuk janë implementuar cilat janë arsyet. Ne jemi koshient që vullneti është një diçka, dëshira është diçka, mundësia e zbatimit është diçka tjetër. Por, nëse mungesa e implementimit ka të bëjë me shkaqe subjektive, zvarritjesh, burokracish apo pengesash lehtësisht të kapërcyeshme, atëherë na takon ne që të ushtrojmë trysninë e mjaftueshme mbi ekzekutivin.

Sigurisht rolet janë të ndryshme, kjo është Qeveria ajo që ka një funksion për ekzekutivin. Ne jemi përgjegjës për legjislacionin, për të përmirësuar atë, për të propozuar ndërhyrje në legjislacion ne jemi përgjegjës për të ..., mbikëqyrur, monitoruar punën e Qeverisë. Çka më duhet të pranoj të paktën nga pjesa jonë ka shumë hapësira për tu përmirësuar Parlamenti dhe roli i Parlamentit duhet forcuar, roli i komisioneve është i jashtëzakonshëm, nuk e druham të them se komisionin ku unë kam nderin dhe privilegjin të drejtoj teksa diskutojmë për ligjet nuk shohim njëri-tjetrin nga ... partiake, por e shohim nga logjika e diskutimit sigurisht që janë seancat parlamentare pjesa e shfaqjes prej vërtetës kur pyeta për kamerën, thashë kamera është sa herë kemi kamera aq herë na turbullojnë diskutimi në komision, nuk e di se si ndodh me ju, por them të drejtën në komision druaj se është në gjithë botën jo vetëm ke ne, por ama jo nuk ka të bëjë me atë, ka të bëjë domethënë e kam hasur këtë eksperiencë edhe komisionet në vendet e zhvilluara të Bashkimit Evropian. Madje, të njëjtin shqetësim ndajnë edhe ato sa herë i kemi kamerat aq herë na devijon debati.

Por, ama është shumë e rëndësishme që për qytetarët, ne të debatojmë për çështje që afektojnë jetën dhe përditshmërinë e tyre. E kemi arritur të paktën që një mori ligjesh të ardhura nga Qeveria apo jo nga Qeveria të bëhen objekt i debateve konstruktive, sepse e dimë fare mirë se çfarë impakti mund të ketë një ligj i keq për qytetarët, dhe çfarë impakti ka një ligj i mirë.

Pjesa tjetër, që unë do të doja të theksoja përveçse monitorimet e marrëveshje që qeveritë respektive kanë bërë, shumë e rëndësishme është dhe përmenda sfidën e energjisë, edhe Kosova dhe ne jemi ulur në një tryezë rreth komunitetit të energjisë. Fatmirësisht ka tashmë një politikë të qartë të Bashkimit Evropian për sektorin e energjisë dhe integrimin e Ballkanit dhe jo vetëm të Ballkanit ato kanë shkuar përtej Ballkanit, Ukraina kanë bërë pjesë edhe vendet e tjera me Gjeorgjinë po negociojmë të rrjetit dhe sistemit energjetik duke parashtruar një legjislacion për të cilin edhe ne edhe ju jemi të detyruar ta zbatojmë dhe ta aplikojmë.

Sigurisht që kemi specifikat tona, dhe me të drejtë do të vu në dukje edhe nga zoti ... gjatë takimit të mëparshëm që politikën e përbashkëta nuk duhet të na lejojnë që të implementojmë në

të njëjtën kohë artikuj apo nene të veçanta të marrëveshjeve, të cilat kanë impakte të ndryshme për shkak të specifikave të ndryshme që kanë vendet tona. Çka do të thotë që nga këmbimi i eksperiencave pozitive apo edhe negative mund të mësojmë nga njëri-tjetri.

Dhe, nëse ne po adaptojmë me shpejtësi një legjislacion në sektorin e energjisë do të ishte shumë e dobishme për ju që të njiheshit me mënyrën se si ne po e aplikojmë, mënyrën se si ne po e debatojmë ashtu sikundër për ligje të veçanta tuaja do të ishte me shumë interes për ne, për të kuptuar filozofinë e debatit. Pra, kemi shumë ne për të marrë dhe për të dhënë me njëri-tjetrin dhe për të mësuar edhe nga njëri-tjetri për sektorë të ndryshëm. Kështu që unë do të propozoja që për ta bërë më konkret bashkëpunimin të piketonim mundësisht duke dhënë edhe disa afate pikat konkrete të bashkëpunimit midis dy komisioneve. E them nuk mund të bëjmë mrekullira nuk mund të zgjedhim dhe nuk kemi çelësin e artë të zgjidhjes së problemeve brenda një kohe të shkurtër, por të paktën kemi mundësinë që të japim një shembull, meqenëse jemi te komisioni ... një bashkëpunimi të tillë dhe vullneti nga të dy parlamentet është i padiskutueshëm të bëjmë konkret fushat, mënyrën dhe pjesën e çështjeve që do të diskutojmë paraprakisht. Pra, nëse themi do të monitorojmë marrëveshjet që dy qeveritë kanë lidhur dhe në çfarë stadi janë atëherë të ketë një raportim nga pjesa jonë e ekzekutivit atje, pjesa e juaj e ekzekutivit këtu për t'i ballafaquar dhe për të parë se çfarë ka shkuar dhe çfarë nuk ka shkuar. Çfarë nuk ka shkuar ka qenë për shkaqe objektive apo për shkaqe subjektive. Këmbimi i informacionit për pjesën e diskutimit të ligjeve, dhe e treta që kemi thënë në takimin e fundit është që ne Komisioni Veprimtaria Prodhuese e kemi nxjerr jashtë dyerve të Parlamentit. Pra, nuk mblidhemi vetëm në Parlament, por ne organizojmë dhe vizita nëpër industri të ndryshme. Kemi parë nga ..., kemi diskutuar për bujqësinë në ... , kemi vizituar hidrocentral mbi lumin Vjosë, kemi parë si shkojnë bizneset e një sektori të veçantë.

Pra, jemi mbledhur jo vetëm në tryezën e komisionit, por jemi mbledhur dhe në terren. Çka na ka shërbyer më mirë për të njohur dhe për të kuptuar problematikën. Kështu që këto kisha, pastaj tash kolegët janë të lirshëm.

**KRYETARI:** Zoti Qela, i pari është lajmëruar.

**RAIF QELA:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nga Komisioni për Veprimtari Prodhuese, Tregti dhe Mjedis.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Më vjen shumë mirë që po i vazhdojmë këto takime ndërmjet dy komisioneve dhe besoj se do të bëjmë hapa konkret drejt realizimit të disa prej atyre synimeve që mund t'i realizojmë bashkarish.

Duke qenë se jemi dy shtete të ndryshme, por jemi pjesë e një kombi nuk do të ishte dashur t'ia lejojmë stuhisë që e ardhmja jonë të varet vetëm prej marrëveshjeve tek-tuk, porse duke e pasur parasysh se që të dy jemi për botën, tregje të vogla dhe në fund të fundit jemi në bisht të Evropës me zhvillimin ekonomik, kemi nevojë për intensifikim të marrëdhënieve në të gjitha fushat e jetës.

Përfitimet prej saj janë të mëdha, i dini edhe vetë fushat kryesore në të cilat do të ishte dashur që ne të bëjmë hapa shumë më konkret drejt realizimit të marrëveshjeve deri në realizimin e një tregu të përbashkët në mënyrë që jetën e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës ta bëjmë më të mirë edhe të shkojmë drejt integritimeve, sepse ajo sjell përfitime të mëdha.

Konkretisht mendoj se kjo përbërje edhe jep rezultate me takime të tilla, por mendoj se do të ishte dashur të bëhet edhe më konkrete, edhe brenda Qeverisë, edhe brenda Kuvendit do të duhej të ekzistonin trupa jo që të mblidhen qeveritë vetëm një herë në vit, apo edhe komisionet tona të mblidhen një herë në vit a gjashtë muaj, por të krijoheshin trupa respektivisht mekanizma të përbashkëta, të përhershme, të cilat për shembull në Kuvend do t'i kishin këto detyra: t'i mbikëqyrnin realizimin e marrëveshjeve të deritashme, të cilat edhe ashtu ne mund t'i bëjmë, por nëse zgjidhet një trup e përhershme e Kuvendit dhe janë realizuar marrëveshje për marrëveshje, analizon realizimin e secilit veç e veç do të ketë rezultate shumë më të mëdha.

Të inicionte marrëveshje të reja, të punonte në përafrimin e legjislacionit qysh e përmendën edhe dy kryetarët e komisioneve tona dhe të jepte shpirt institucional integritet kombëtar. Këto besoj se do të ishte dashur ne sot këtu të inicionim formimin e trupave të përhershme të përbashkëta në mënyrë që këto marrëdhënie të intensifikoheshin.

I dini shumë fusha, në të cilat përfitimet janë tepër të mëdha disa prej tyre vetëm i kemi identifikuar, është mirë që është kryer ... nga ana fizike ka mbetur vetëm edhe problemi politik i raportit me Serbinë në mënyrë që një vepër e madhe e përbashkët të realizohet dhe të shkojë drejt unifikimit të sistemit energjetik në përgjithësi, sepse ajo do të jepte përfitime shumë të mëdha.

Krijimi i këtyre mekanizmave do t'i detyronte ata që punojnë aty të merren në mënyrë më të ngushtë me at çështje, jo se ne të merremi me të gjitha çështjet e tjera, por ata që do të ishin të përcaktuar të punojnë aty ta kishin për detyrë si të them primare atë dhe sigurisht që rezultatet nuk do të mungonin. Sado që nuk po them që di shumë, vullnetin e kam që kushdo që ka vullnet të punojmë qoftë edhe krejt vullnetarisht vetëm t'i përafrojmë... krejt këto çështje të cilat mund t'i përafrojmë bashkërisht. Faleminderit!

GENC RULI: Faleminderit, i nderuar kryetar ose të dy kryesues të këtij takimi, Qëpari dua të shprehë kënaqësi që kam për këtë takim që bëjmë ne e quajmë takim i kthimit duke pasur parasysh takimi e mëparshëm në Tiranë, nuk është takimi i mbarimit për arsye se këtu kemi pa dyshim takime të tjera.

Më erdhi mirë që të gjithë parafolësit duke filluar nga dy kryetarët respektiv edhe Raifi përmendën atë më konstatim që kemi që bashkëpunimi nuk është shumë ... bashkëpunimi ekonomik dhe kjo është realitet, po të kthehem pas më ... nga vullneti dëshira ... për bashkëpunim dhe të paktën po flas për 10 vjet, më shumë kemi prodhuar retorik se sa bashkëpunim.

Dhe ndoshta edhe kjo është e arsyeshme, ndoshta vërtetë ishte shumë e vështirë të kishim një shkëmbim ekonomik dhe tregtar tepër të fuqishme duke menduar që dyja jemi ekonomik të dobët. Por kjo nuk ish arsye që në agjendën tonë s'do të jetë bashkëpunimi. S'dua bimë pre asaj retorike të cilën nganjëherë mbajmë në ... deri në takime të përbashkëta të Qeverisë por realiteti lëviz më pak dhe shumë më ... se sa ky vullneti deklamuar politik.

Së pari siç e thash në fund të fund jemi dy ekonomi me fuqi të vogël investuese që mund të jemi investitor tek njëri tjetri, maksimumi kemi transferime të vogla kapital e reciprok nga Kosova në Shqipëri apo nga Shqipëria në Kosovë por dy dyja palët të dyja ekonomitore investimet e tuaja i shohim nga partnerët shumë më të fuqishëm nga jashtë nesh në Evropë apo kudo që të jetë, e duhet ta keni edhe ju fuqi prodhuese prodhime kombëtar të ulët, kryesisht kemi prodhim bujqësorë ose me një faktur do të thoja të industrisë së ulët jo të ...prodhim të industrisë ushqimore apo të shërbimeve të ndryshme e tjerë. Ndonë servitje do të thoja edhe këto në vetvete por tepër i kemi të natyrës së tillit që nuk janë komplementare por janë konkures me njëra tjetrën dhe po të qojmë në atë që kemi vëzhguar dhe kapur incidente të ndodhur në shkëmbimet tregtare bëhen o për patate, o për millin o për qumështin pak një .. për birën.

Pra, mendojmë që këtu hyjmë nga ajo që quhet garë në me prodhuesve tanë, kështu që të jemi realist brenda optimizmit tonë dhe skepticizmit që kishim se s'kemi shumë këmbime tregtare ky është një realitet të cilën do ta vlerësojmë.

Sigurisht ne si ... politik si parti, si Kuvend, si Qeveri kemi mundësi të nxisim edhe më shumë. unë do të thoja siç u përmendën fjala profesor Mustafa ne do të shohim kryesisht çfarë mund të ndërtojmë, të konceptojmë së pari, jo thjeshtë duke kërkuar që e koncepton njëra palë dhe pala tjetër duhet të bashkangjitur. Ne nuk kemi asnjë projekt të hartuar bashkërisht.

Rruga e kombit nisi si projekt ne u vazhduam nga Kosova dhe mirë u bë, ama nuk besoj që ka projekt që është bërë nga të dyja palët bashkë që në koncept është bërë gjithë përpjekja për inxhinjering financiare të saj për gjithë burimet tjerë po bashkërisht të realizuar dhe ..se nuk kemi nevojë për projekte të tilla ose projekte kombëtare me vlerë për të dyja vendet po qe prapë na ka sugjeruar agjencitë e huaja KfV-ja për ... e të tjera. Pra, këtë vullnet për të konceptuar projekte të përbashkëta dhe këtu u përmend ende se kemi realizuar, se kemi pas deri më sot ... do të thoja nënprojekte të tilla sektorëve strategji në projekte strategjike do të quaj që kanë dobi imëgate për të dyja vendet, përmendëm këtë të infrastrukturës u kalua deri te hekurudha, kemi linjat e komunikimit do të thoja për telefonisë të internetit e tjerë të cilat detyrimisht duhet konceptuar vetëm si projekte të përbashkëta se vërtetë po zgjasin lidhjen me kabllo optik midis Kosovës dhe Shqipërisë po ku mbaron ajo. Shqipëria ... që lidh me Evropën e ka të pamjaftueshme për të përballuar fluksin e vetë jo me përballua një fluks akoma më të madh që gjenden me shumë ... ekonomike. Janë këto projekte të dhënë konkretisht në temën e realizimit të sinqertë të qartë dhe me vullnet një gjë që i vlen dy palëve bashkërisht.

Dhe sigurisht një element tjetër që u përmend është velecimi në rregullatorë. Ne jemi dy vende që po bëjmë ligje, ca i bëjmë me shpejtësi sepse na kërkojnë proceset integruese ose agjendet që na inponohen bëne këtë ligj, benë atë ligj me standarde evropiane që më tepër siç janë fuqitë tona për të realizuar ato standarde kush.... i dinë këto ligje dhe shumë herë kemi edhe ... përplasje mes këtyre ligjeve, mes këtyre rregullimeve mes njëri tjetrit.

Rastet që përmenda mund të jenë minore po kanë qenë minore sepse aq ka qenë edhe konkurrenca në lidhje për ... po të ketë një konkurrencë më të madhe këto lloj përplasjesh, këto lloj mos ... të ndryshme mes legjislacioneve gjëja të cilat në marrëveshje që janë lidh deri më sot pikërisht .. parashikuar që të shmangen këto gjithsesi, këto nuk janë realitur ende.

Dhe prandaj po them që kjo është një hap më i parë, më pak ... që mund të realizohet më shpejtë lehtësimit dhe njësimi do të thojë i standardeve, i rregullave të lëvizjes së mallrave të shërbimeve dhe e dyta që e përmenda për projekte strategjike të cilat duhet fillojmë dhe të konceptojmë së bashku dhe të realizojmë së bashku. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Zoti Grainca, mandej deputeti Beqaj e të shohim edhe këndej sigurisht, shkojmë një nga një këtu.

**BLERIM GRAINCA:** Zoti kryetar,

Kolegë të nderuar,

Bashkë kryesues dy kryetar, ju përshëndes të gjithëve,

Edhe për mua është nderë dhe kënaqësi një takim i tillë dhe të drejtën unë po e konsideroj si një takim i Komisionit të përbashkët me shpresë se kjo të ndodhë në një ta afërme të afërt.

Gjithsesi marrëdhëniet mes dy vendeve tona nuk janë të bazuara vetëm në këtë filozofinë politike e ekonomike por më shumë janë vëllazërore dhe bazuar në lidhje edhe shpirtërore edhe emocionale që kanë të themi qytetarët e vendeve tona.

Unë nuk mund pa e përgëzua dhe pa e falënderuar gjithë shtetin shqiptarë për gjithë përpjekjet që po bënë në vazhdimësi për të ndihmuar Kosovën në anëtarësimin në mekanizma të ndryshëm qofshin ata që lidhen me ekonominë apo me mekanizma të tjera dhe në këtë frymë unë shoh edhe deklaratën apo marrëveshjen për partneritet strategjik të nënshkruar midis dy vendeve tona.

Kolegët e mijë parafolës folën për këto zhvillime më shumë makro që lidhin dy vendet tona megjithatë unë pritjet e mija nga ky takim kanë qenë që ne të flasim më shumë për gjërat praktika që e rëndojnë lëvizjen e qytetarëve tanë, bizneseve dhe ekonomisë tonë, domethënë të merremi paka shumë me problemet e natyrave teknike dhe operative në baza ditore.

Është e vërtetë që ne jemi të thirrur për të krijuar legjislacion dhe për të përcjell edhe zbatimin e saj dhe të marrëveshjeve të nënshkruara mes dy vendeve, por është një konstatim i përbashkët të gjithë opinionit publik të them në Kosovë se në këtë rrafsh kemi bërë pak apo jemi larg synimeve dhe projeksioneve të arritura.

Ne kemi disa marrëveshje të nënshkruara të cilat në praktikë faktikisht po përcillen me një mosimplementim gjegjësisht me një shkallë të atillë burokratike që po krijojnë pengesa të atilla që po e pengojnë zhvillimin apo të themi edhe marrëdhëniet tregtare mes dy vendeve edhe ashtu të brishta në fushën e ekonomisë.

Nëse më kishit më lejuar nuk do të kisha ilustruar dy tri probleme që janë të fushave praktike.

Mirë profesor do të provoj mirëpo për shembull asociacionet e biznesit kanë vërejtje të shumta që lidhen me mosharmonizimin e standardeve të themi të dyfishta që përdoren në dy vendet e tona, veçanërisht në ato që kanë të bëjnë me këto certifikata e lebarotoreve të ndryshme të lëshohen në Shqipëri dhe në Kosovë dhe të cilat nuk janë komplementare nuk e njohin njëra tjetrën.

Dhe një biznes që eksporton nga Shqipëria në Kosovë apo nga Kosova në Shqipëri me këto barrierë has në kufij në pikën e parë doganore dhe kjo i shkakton edhe kosto kohore edhe financiare. Pastaj është një anomali që e kanë listuar bizneset kosovare për shembull që autoritetet në Shqipëri kërkoj që të gjithë dokumentacioni përcjellës që vjen nga Republika e Kosovës të jetë i noterizuar tek noteri do të thotë e vlerësojnë më shumë noterin se sa një certifikatë lëshuar nga institucioni i Republikës së Kosovës ....

Po ashtu, nuk është mirë ndoshta s'po e gjej një shprehje adekuate, por në pikat kufitare bizneset tona që eksportojnë në Shqipëri, por përveç barrierave të caktuara burokratike po hasim edhe në siç kanë listuar Oda Ekonomike e Kosovës edhe në problemet të natyrave tjera që lidhen me vonesa të qëllimshme, qoftë si rezultat i konkurrencës lobimeve që bëjnë prodhuesit andej apo këndej.

Për shembull, ndalen ... me ditë të tëra në pikën kufitare vetëm që mallrat e caktuar të mos arrijnë te tregu shqiptar me kohë apo them se mund të ketë edhe në anën kosovare të njëjtën gjë, nuk po e adresoj këtë si problem.

Kemi një problem tjetër që lidhet edhe me industrinë farmaceutike të Kosovës, kemi mbi 36 kërkesa të kompanive kosovare për tu futur në tregun shqiptar dhe kanë arritur të certifikohen, të licencohen nga institucionet përkatëse në Shqipëri vetëm tri nga ato. Tani duhet parë a janë probleme të natyrave të kualitetit të mallrave apo janë probleme që kanë kërkesë...

Ministria jonë e Transportit dhe Infrastrukturës, të nderuar kolegë, ka listuar edhe një varg problemesh të natyrave teknike me të cilat po ballafaqohemi në komunikimet. Për shembull, ministria jonë ka një vërejtje në Ministrinë e Infrastrukturës apo Transportit të Shqipërisë, e cila nuk është si të themi efikase në komunikimin në mes dy ministrive. I dërgojmë me shkresa të tëra, veçanërisht me lëndët që kanë të bëjnë me qarkullimin e mallrave dhe udhëtarëve në Republikën e Shqipërisë, kanë një burokraci të hatashme në komunikim. Ky është opinionimi i ministrisë tonë, nuk e di cili është opinionimi i ministrisë të këtij rangu mund të jetë i njëjti, por këto gjëra do të duhej t'i shikonim në ...

Pastaj, kemi pengesa të njohjeve të ... e tjera, apo që është një pengesë e jashtëzakonshme, një udhëzim administrativ, të cilin e ka nxjerr Qeveria e Shqipërisë e që ka të bëjë me sasinë e derivateve që duhet të kenë ... që futen në Shqipëri. Të gjitha... nga Kosova nuk lejohet të kenë një sasi të caktuar të karburanteve me qëllim që ato të furnizohen në Shqipëri ku kostoja dhe çmimi i naftës është më i shtrenjtë.

Domethënë, kjo nuk mund të përdoret në një vend tjetër, por me Kosovën mendoj se nuk duhet të ishte një qasje e tillë sepse do e detyrojë Ministrinë tonë të Infrastrukturës të marrë masa të

reciprocitetit dhe nuk dëshirojmë ky bashkëpunim të arrihet në atë nivel. Unë kam edhe kam marrë nga agjencionet edhe një numër të caktuar të dënimeve që u janë shqiptuar bizneseve bazuar në këtë udhëzim, ku për shembull thotë që dënohet për sasinë mbi limitin e lejuar të naftës. Domethënë, është një anomali ...

Mirë, unë po i ngris si shqetësime. Kam edhe dy-tri çështje të vogla, kryetar.

KRYETARI: E thashë, edhe mirë është me i cek këtu po unë propozova mirë mund t'i cekim disa më të mëdha, por propozova që secili t'i marrim dosjet tonë dhe të krijojmë një interpelancë me organizatat që bëjnë ato pengesa.

BLERIM GRAINCA: Kryetar, nëse më lejon unë do e mbyll...

KRYETARI: Urdhëro, Blerim vazhdo! Unë e propozova këtë, por sigurisht që disa gjëra që janë më të rëndësishme mund t'i cekim.

BLERIM GRAINCA: Për të eliminuar të gjitha këto barriera unë mendoj se do të duhej të lobonim të dy komisionet edhe për hapjen e një pike të re kufitare te Gjakova, ku deri tash tani kemi vetëm qarkullim të ..., do të thotë të shërbejë edhe për qarkullim mallrash, për arsye se do e lehtësonte komunikimin mes të themi dy anëve të asaj pjese të kufirit dhe niveli mes asociacioneve, bashkëpunimi mes asociacioneve ekonomike të jetë një standard.

Domethënë, të bëhet në baza mujore, gjashtë mujore jo të jenë ad hoc takime dhe një fushë ku mendoj se roli i komisionit të juaj do të ishte mjaft frytdhënës dhe ishte fusha e turizmit në sensibilizimin e opinionit shqiptar për të pasur një qasje më të mirë, dhe për të vizituar më shumë Kosovën sikur që e dini vitin e kaluar mbi 700 mijë kosovarë kanë pushuar në Shqipëri. Dhe, të ardhurat që ka marrë nga Banka Qendrore, të hyrat që ka marrë buxheti i Shqipërisë janë mos të them qindra milionëshe, sepse ish guvernatori pastaj do të na, por unë ju inkurajoj që të punojmë më shumë në këtë fushë për arsye se në çdo vikend kemi me mijëra nxënës kosovar që në mënyrë të organizuar shkojnë për të vizituar Shqipërinë, kurse në anën tjetër nuk kemi asnjëherë.

*(Ndërhyrje)*

Kolegë të nderuar, unë mund të flas për makro sa të doni, por problemet janë të natyrave teknike.

EDUARD SHALSI: Kam vetëm një në aspektin procedural, unë do të sugjeroja që ne të stabilizojmë mënyrën e bashkëpunimit. Nëse do të ndalemi në pika të veçanta jo nuk është, janë të rëndësishme për mua, por për mua është më e rëndësishme mënyra se si do të komunikojmë dhe bashkëpunojmë.

Çka do të thotë? Në rast se lind një problem si ai që përmendi Blerimi, që ka të bëjë me vërtetim tek noteri, analizave laboratorike të produkteve... pra ka ardhur një shqetësim në vëmendjen tuaj, dakord, konkret si deputet. Atëherë, si do të komunikojnë komisionet, pra në radhë të parë ne do të duhet them unë të stabilizojmë mënyrën se si do të bashkëpunojmë. Do të



bashkëpunojmë një, në këmbimin e legjislacionit. Pra, çfarë jeni duke shqyrtuar ju, çfarë jemi duke shqyrtuar ne. Si do të bëhet kjo?

Sekretaria e komisionit tonë, me sekretarinë tuaj një herë në muaj ose sa herë bie fjala miratojmë kalendarë dhe programin e Kuvendit, ia vendosim në dispozicion sekretarisë tuaj dhe anasjelltas. Po e marr si rast konkret, por e para. E dyta, nëse vjen një problem tek ju që ka të bëjë me një çështje të caktuar. Atëherë, problemi i deputetit i prezantohet komisionit, mbledhja formale, jo formale pak rëndësi ka kjo për ne. Por, mënyra se si ne do të informohemi mbi këtë problematikë, sepse të gjitha këto pika ne do të duhej t'i dimë ku t'i adresojmë dhe sa qëndrojnë.

Nuk synoj unë për shembull dhe gjatë punës time, nëse marr ankesa nga një biznesmen apo nga një sektor apo nga një tjetër kam tendencën ta shtrojë problemin, jo individualisht, sepse ndryshe do t'i shërbejë një biznesi që është shumë e rëndësishme, por ndryshe do të ishte nëse ky problem afektonte të gjithë sektorin e caktuar. Pra, e para të vërtetojë nëse është një problem që e ka një biznes i caktuar dhe sa i madh është, çfarë ndikimi ka.

E dyta, është nëse është problem sektori, pra ka mundësi të kontaktojë me ne një tjetër nuk ka mundësi të kontaktojë me ne. Pra, lista e problematikave sipas zërave, por të kalojë edhe nëpërmjet një të themi filtri nga sektori, nga të themi sektori ligjor, pra kemi të bëjmë me një mos aplikim të ligjit, pra nga një dëshirë e një doganieri që shpeshherë dhe rëndom ka ndodhur në të kaluarën apo kemi të bëjmë me një mospërcaktim të qartë procedure, apo kemi të bëjmë me një çështje e cila ka nevojë për adresim ligjor. Pra, ka nevojë për tu ndryshuar ligji.

Pra, pika e parë pra ishte komunikimi i agjendave, e dyta është monitorimi do të thoja unë, do të sugjeroja i marrëveshjeve të dy qeverive, e treta është pikërisht problematika të tilla. Dhe në qoftë se ne ecim me këto të tre pikat unë besoj se do të ishte e mjaftueshme të paktën për, sepse nuk do të mund të pretendojmë që të vrasim dhjetë zogj në të njëjtën kohë dhe të pretendojmë që mund të bëjmë gjëra të shumta brenda një njësie kohore të caktuar.

Pra, të përcaktojmë nëse një problematikë e tillë si kjo vjen në komisionin tuaj si transmetohet te komisioni apo anasjelltas, një problematikë e jona. Pra, do të doja që ta kanalizoni dhe të bini dakord në groso-modo themi ne, në suigeneris për mënyrën e bashkëpunimit dhe ta mbanim diskutimin pikërisht tek përcaktimi i këtyre gjërave, sepse Blerim jo pse kam problem me çështjen e veçantë por do të doja që të përcaktonim fillimisht mënyrën e procedimit të kërkesave.

(Ndërrhyrje)

**KRYETARI:** Zoti Bitri e ka kërkuar fjalën!

**ROBERT BITRI:** ... Unë duke vazhduar me këtë që tha Genci dhe kryetari. Ne nuk mund të zgjidhim probleme prej qeverive sepse, të jemi realistë, ne për probleme të tilla ne nuk futemi as te pjesa e Qeverisë tonë as te pjesa e Qeverisë tuaj për zgjidhjen e gjërave individuale. Ne me të vërtetë mund t'i kërkojmë por gjithmonë se ajo për çka duhet të bashkëpunojmë është njësimi i standardeve për të cilat ne duhet të punojmë.

Në qoftë se ne do të njehsojmë standardet atëherë automatikisht ne do të kemi të njëjtin trajtim si për shqiptarët e Shqipërisë ashtu edhe për shqiptarët e Kosovës, si për transportuesit shqiptarë ashtu edhe për transportuesit e Kosovës.

E dyta. Ne duhet t'u kërkojmë qeverive tona që të njehsojmë jo vetëm këtë pjesë por edhe fushat në të cilat ne mund të bashkëpunojmë.

Themi se qoftë Kosova qoftë Shqipëria përfitime më të mëdha do të kenë te pjesa e bujqësisë, turizmit, përpunimit bujqësor, të paktën aq sa e njoh unë dhe flas diku për pjesën e Shqipërisë dhe në këtë fushë propagandimi i të dy palëve, i të gjithë neve, mund të ndikojmë në politikat qeverisëse jo vetëm për standardizimin dhe jo vetëm për përmirësimin ligjor, por edhe për fushat ku ne vërtet duhet të bashkëpunojmë, sepse nuk kemi pse të konkurrojmë, e kemi një fat, kemi ndryshime klimaterike të cilat mund të na favorizojnë në shtrirjen më të gjatë të prodhimeve bujqësore dhe në shkëmbimin e momenteve me të cilët ne do të bashkëpunojmë, që prodhimet shqiptare të vijnë shumë qetësisht në Kosovë dhe e njëjta gjë nga Kosova në Shqipëri.

E dyta, ajo që thatë ju – turizmi. Në radhë të parë të fillojmë ne të luftojmë në një pikëpamje tjetër, dhe vërtet Kosova në këtë aspekt është shumë më konkrete sepse të gjitha shkollat bashkëpunojmë për pjesën e reklamave turistike, për shkak të detit që ne kemi, por turizmi bëhet edhe në vendet malore, dhe në këtë pikëpamje njohja e Kosovës, se ne vërtet luftojmë dhe dalim për njohjen e vendit tonë, të cilin ne e kemi të përbashkët, atëherë kjo gjë do të fillojë edhe çik me reklamat dhe propagandimin e këtyre gjërave që ne i kemi.

Çka kemi ne pjesë më të bukura, çka kemi ne pjesë më të mira, çka kemi ne pjesë për t'u vizituar nga nxënësi i shkollës qoftë në programet mësimore, qoftë në programet tjera, sepse programet e të dy ministrive për njohjen e vendit tonë dhe njohja e vendit tonë është që ne ta njohim që nga veriu deri në jug, dhe kur themi nga veriu në jug do të themi nga Çamëria e deri në Kosovë. Dhe në qoftë se ne kemi edhe pjesë të tjera, atëherë nuk na kushton asgjë që të paktën Kosova dhe Shqipëria të jenë një, që ne ta quajmë atë një treg, që të themi se e kemi një treg dhe do të kemi të njëjtat interesa të përbashkëta.

Ne nuk mund të futemi te pjesa e veçantë, nuk mund të ndërhyjmë në pjesë të veçantë sepse për këtë gjithsecili e ka mendjen e vet, dhe brenda një familje dikush merret me bujqësi, dikush me tregti dhe nuk mund t'i detyrosh këto gjëra në mënyrë kaq strikte. Por, ne që jemi njerëz që i bëjmë ligje, ne që jemi njerëzit që bëjnë politikë, ne që jemi njerëzit që bëjnë dhe krijojnë mundësia për bashkëpunim – duhet të fillojmë të luftojmë dhe të mendojmë njësoj, të mendojmë për vendin tonë dhe vendi ynë është i të gjithëve, edhe Kosova, edhe Shqipëria.

Dhe në qoftë se ne do të fillojmë të mendojmë kështu, automatikisht ne do të fillojmë të shikojmë si gjë të përbashkët, të tërën, dhe duke e parë si të tërën të përbashkët ne kemi mundësi që të bashkëpunojmë dhe të përcaktojmë saktësisht edhe politikat në të cilat do të bëhet i gjithë ky bashkëpunim. Ne duhet të vijmë, dhe ajo që kemi ne mundësinë në radhë të parë, të bëjmë politikë, të bëjmë ligje dhe të detyrojmë qeveritë tona të zbatojmë ato të cilat i shkruajmë dhe i nënshkruajmë vetë.

Pastaj, te pjesët e veçanta ne kemi pakënaqësia sikur ju për doganat, për Qeverinë, për të gjitha gjërat. Kështu edhe ne andej, dhe po të gjejsh tregtarët tërë kohën ata e thonë të njëjtën gjë, dhe më merr dikush në telefon dhe më thotë – ore ma arrestuan djalin. Po çfarë problemi ka? Hiq s'ka, është një problem i vogël. E çfarë problemi? Kalojë një mall, thotë, pa doganë. Shumë faleminderit!

(flet pa kyçje të mikrofonit)

KRYETARI: Blerim, të gjitha që i ke folur ti ne u kemi dhënë një dosje dhe do t'i shikojmë. Tash e ka fjalën zoti Beqaj! Unë gjithmonë pres diskutimet provokuese, por të ecim tutje. Unë e thashë në fillim atë çështje. Urdhëroni Besim!

BESIM BEQAJ: Faleminderit kryetar! Unë ju kërkoj falje sepse pas 10 minuta, më duhet të udhëtoj dhe nuk do të kam mundësi ...

Besoj se prej momentit kur kemi filluar të kemi takime të përbashkëta dhe po kalojmë në bashkime formale gjërat janë kah shkojnë më keq. Kjo është përshtypja ime.

Pse po e them këtë, më duhet ta argumentoj. Unë kam qenë në takimin e parë të dy qeverive, kam qenë ministër dhe kemi bërë marrëveshje, kemi bërë gjëra të cilat nuk janë duke u implementuar dhe për fat të keq asnjë projekt i përbashkët nuk është nisur prej atëherë e deri më tani.

Kemi mbetur prapa dhe duhet ta adresoj edhe një vetëkritikë për ne, por edhe për juve, se që 40 minutë po flasim çka do të duhej bërë, do të duhej kështu, e do të duhet ashtu, parimisht nuk kishim ndonjë konkludim, ose po shkojmë në gjëra krejt makro, ose në gjëra krejt mikro dhe po na mbetet ajo zbrastësira themelore që realisht do ta inicioje bashkëpunimin në mënyrë të mirëfilltë.

Cilat janë projektet e përbashkëta që janë bërë pa pasur takime të përbashkëta të qeverive dhe pa pasur takime të përbashkëta të grupeve parlamentare.

Është bërë abetarja e përbashkët dhe besoj se është projekt shumë i madh. Është filluar rruga, edhe pse zoti Ruli e tha se s'ka pasur marrëveshje të nënshkruara por ka pasur harmonizim të plotë në mes të dy qeverive për ta iniciuar rrugën sepse ka qenë goxha problematike sepse është konsideruar rrugë politike atëherë, edhe për Shqipërinë edhe për Kosovën, është bashkëpunuar në mënyrë ditore për ta ndërtuar linjën e interkonteksionit, janë dy qeveri rreshtazi që kanë punuar do të thotë pa takime të përbashkëta.

Unë kam marrë pjesë në shumë takime kur e kemi diskutuar atëherë me Bankën Botërore fizibilitetin se kah duhet të shkojmë dhe kah duhet të lidhemi, do të thotë është realizuar interkoneksioni, dhe sot jemi në diskutim për tregun energjetik të përbashkët i cili parimisht do të duhej të ndodhte, por më shumë po na shtojnë të huajt se sa ne vetë... për këtë projekt energjetik të përbashkët. Dhe ky projekt ka filluar në kohën kur unë kam qenë ministër i Zhvillimit Ekonomik, ka ardhur me iniciativë nga USAID, USAID i ka paguar ekspertët,

USAID-i e ka bërë fizibilitetin, ... na ka ndihmuar por jo që realisht është pasu shumë pas këtij veprimi.

Pra, ne që jemi tash duke folur sepse besoj që zoti Ruli e tha me shumë elikuencë, ne kemi çështje të projekteve të përbashkëta, pra ne të si dy institucione. Do të thotë duhet ta ndajmë bashkëpunimin, një bashkëpunim institucional dhe bashkëpunim të sektorit privat.

Çka jemi kah bëjmë ne qe 3 a 4 vite, instituonalisht po takohemi, po shprehim dashamirësi vëllazërore, raporte vëllazërore por që realisht nuk po përmirësohet bilanci tregtar. Shiheni strukturën e eksporteve dhe importeve që i kemi. Asnjë eksport i mirëfilltë i Shqipërisë, me përjashtim të çimentos, nuk është në Kosovë. Janë derivatet e naftës, janë gjërat tjera, të cilat vijnë qoftë edhe për importe të ndonjë prodhim të vogël, ose produktet që ne i dërgojmë atje. Pra nuk kemi ndonjëfarë qëndrueshmërie, dhe mos të themi se këto gjëra të cilat i kemi për momentin kanë ndikim shumë të madh.

Pra, çfarë është bashkëpunimi institucional, këtë që e tha zotëri Bitri? Hajde t'i iniciojmë standardet, hajde të iniciojmë agjencionin e ushqimit të veterinës me atë, si thirret, me AKU-n atje.

Unë kam pasur takime para 3 vitesh në Tiranë me këtë temë dhe nuk është bërë lëvizje, fatkeqësisht dhe këtu është rezultati ynë, sepse duhet një zyrtar i AKU-s atje, nja 3 ditë ose i agjencionit tonë...

(Ndërrhyrje)

Por, vetëm ta përfundoj. Jo, është edhe AKU, sepse ata kanë në mënyrë të drejtpërdrejtë hyrjen e parë. Po ju flas edhe nga këndvështrimi si njeri që jam marrë me biznes goxha gjatë dhe i njoh mirë, në thelb problemet e biznesit, edhe të raporteve tona.

Ne kemi rrëshqit nga takimet zyrtare, ne i kemi eliminuar pothuaj se tërësisht takimet e bizneseve që janë shumë keq. Ne mund të krijojmë bazë institucionale të bashkëpunimit dhe këtë duke i zbatuar ligjet, por bashkëpunimin e problemeve të biznesit duhet t'u lëhen shoqatave të bizneseve, asociacioneve të biznesit dhe ata merren me raste individuale.

Kemi pra probleme tjera të natyrës, këmbimet e informacionit, që e tha zoti Shalci. Besoj se ne këtë mund ta bëjmë. Këmbimi i informacioneve a ka probleme, s'ka probleme, cilat janë standardet, a po zbatohen ligjet apo nuk po zbatohen dhe hajde të shohim strategjinë e programit qeverisës të Republikës së Kosovës, programin qeverisës të Republikës së Shqipërisë dhe të shohim ku i kemi projektet e mundshme të përbashkëta, të nisen.

Duhet marrë diplomaci parlamentare dhe unë besoj që më shumë ne duhet në kuptimin ekonomik të luajmë rolin diplomatik parlamentar bashkërisht se sa me u marrë me gjëra minore të cilat ose vetëm me retorikë të cilën ne parimisht e kemi në funksion. Është diskutuar një projekt tjetër i përbashkët, është bërë një marrëveshje sa i përket pikave të përbashkëta doganore, nuk ka lëvizje! Kam qenë ministër i Financave kur është iniciuar kjo. Nuk ka më

asnjë lëvizje. Do të thotë kjo e kishte hequr tërë atë burokracinë sepse kur ka kontroll të përbashkët do të ishte element absolutisht i drejtpërdrejt në drejtim të kësaj.

Lehtësimet doganore. Lehtësimet rregullatore janë gjëra të cilat janë thelbësore, me të cilat ne besoj duhet të merremi. Por po e them edhe një herë dhe do ta përmbyll, sepse po tentoj të jam më konciz.

Janë katër projekte të fuqishme të cilat shkojnë drejt integritit, sepse ne po flasim me pompozitet, krijimin e një zone të përbashkët të tregut, të një zone doganore, janë dëgjuar edhe kësi far muhabetesh, as njëra as tjetra nuk krijohen për pa i bërë të gjithë këta hapa paraprak.

Zonat doganore, gjëra tjetra, nuk mund të jenë....

(Ndërhyrje)

Jo për tjetër gjë jemi duke folur. Jemi duke folur për zonë të përbashkët doganore që mallrat të kalojnë prej një vendi në vendin tjetër. Sikurse kur kemi folur krejt hava për treg të përbashkët energjetik pa pasur interkoneksion. Ajo nuk do të mund realizohet.

Prandaj duhet t'u shkojmë gjërave një nga një. Dhe ne për të ardhur deri te bashkëpunimi ekonomik dhe të trajtimit të zonës së përbashkët doganore duhet t'i bëjmë pikat e përbashkëta të kontrollit doganor dhe pastaj me ardh atje. Hajde t'ia nisim punëve rend. Faleminderit shumë!

**KRYETARI: Faleminderit! Besnik Baraj!**

**BESNIK BARAJ:** Në fakt, edhe unë si shokët e kolegët këtu ndihem i privilegjuar që jemi në këtë takim, por ndihem pak më shumë se kolegët meqenëse unë jam edhe nip në Gjakovë, nga nëna, kështu që padyshim këto lloj takimesh kanë rëndësi shumë të madhe në nivel kombëtar, si të thuash, për një lloj konvergjence në shumë plane.

Unë do të fokusohem kryesisht në mundësinë e projekteve të përbashkëta në një fushë që nuk e di në emërtimin që ka komisioni i juaj, dhe nuk e di a e mbulon, por në sektorin e mjedisit.

Sektorin e mjedisit, këtu e kam parasysh jo vetëm studime të ndryshme që mund të bëhen në nivel akademik. Para ca viteve kam pasur fatin që të kemi në udhëheqje edhe një kërkues, studiues kosovar për doktoratë, por kjo si të thuash ngelet në fushën akademike që ka një rëndësi shumë të madhe në kohezionin dhe bashkëpunimin e shkollave në përgjithësi.

Por për projekte konkrete, për eko-sisteme që janë të përbashkëta, këtu kam parasysh për shembull në një rast, bile me kolegun Shalci kemi qenë në Liqenin e Fierzës dhe kemi parë një problematikë akute që është kontributi i palës shqiptare por njëkohësisht edhe i palës tuaj në lidhje me ndotjen e këtij liqeni.

Dhe, në Shqipëri është mjaft kritike problematika e mbetjeve urbane, derdhjeve, trajtimit të ujërave të zeza dhe unë mendoj se, duke qenë një eko-sistem i përbashkët fare mirë mund të

merren projekte në nivel edhe të Bashkimit Evropian meqenëse gjithmonë mjedisi shikohet si i njerks dhe askush nga shtetet tona mendon që të investojë rëndësishëm, përveç pjesës, si të thuash mediatike, ka shumë fiktivitet në projekte konkrete për përmirësimin e cilësisë së këtyre eko-sistemeve që padyshim kanë një impakt jo të vogël ekonomik, turistik e tjerë.

Dhe, këtu mund të zhvillohen projekte qoftë për trajtimin e ujërave të zeza, por njëkohësisht mënyrës se si të menaxhohen dhe mos t'i filtrojnë mbetjet e ndryshme të ngurta që transferohen në pjesën tonë, apo sikur që ka ndodhur edhe për Shqipërinë që ka transportuar për shkak të lëvizjes së rrymave detare në pjesën veriore të Detit Adriatik, e jo në Kosovë që s'ka dalje, por në vendet fqinje. Dhe këtu padyshim mund të jetë mendoj një aspekt me interes reciprok.

Duke falënderuar për gjithçka unë mbetem i angazhuar për të krijuar lidhjet të nevojshme dhe pastaj bërja e projekteve u përket institucioneve dhe subjekteve përkatëse, qoftë në fushën akademike, qoftë edhe në nivel shtetëror apo të shoqërisë civile. Faleminderit!

**KRYETARI:** Unë po propozoj se kemi edhe një apo dy nga secila anë, dhe pastaj mund të vazhdojmë diskutimin gjatë drekës, prandaj meqë do të shkojmë në drekë, mos të vonohemi, për arsye se edhe mysafirët kanë udhëtuar gjatë dhe ka shkuar kohë vonë për drekë. Urdhëroni! Sala Berisha-Shala e ka fjalën!

**SALA BERISHA-SHALA:** Faleminderit kryetar!

Unë do të jem shumë e shkurtër, dhe mora fjalën ta shfrytëzoj rastin e të përshëndes komisionin parlamentar nga Kuvendi i Shqipërisë, kryetarin zotin Shalci dhe deputetët tjerë që janë këtu prezentë.

Besoj se ne, të ndejmë e qëndrojmë edhe me orë të tëra, kemi çka të flasim e çka të diskutojmë për harmonizim të ligjeve, të strategjive, ngecjet dhe ecjet në bashkëpunim tregtar, ekonomik e kështu me radhë, por unë do të dëshiroja që fjalën time ta orientoj te gota gjysmë e mbushur, jo gjysmë e zbrazur, të mendohet ka pozitiviteti.

Unë aq sa kam pasur mundësi të marr informacione nga institucionet tona në lidhje me projektet e përbashkëta të Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë, të dy shteteve në fjalë, unë nga begrandi im proefisonal jam gjeologje dhe tani për momentin jam duke e monitoruar ligjin, se sa po zbatohet Ligji për miniera dhe minerale, i cili është obligim dytësor, menjëherë pas bërjes së ligjeve dhe kam hasur në këto informacione se të dy shtetet kanë projekte të përbashkëta që parashihen në vitin 2017 dhe projekti i parë është Hulumtimi i arit, platinit dhe gurëve të çmuar.

Ky projekt është e mira që pritet të financohet nga Bashkimi Evropian përkatësisht nga Komisioni Evropian dhe është projekt i përbashkët jo vetëm për Shqipëri-Kosovë por përfshin edhe Maqedoninë dhe ne, përveç të asaj që folëm këtu rreth monitorimit se sa po zbatohen memorandumet, marrëveshjet e projektet në mes dy shteteve, ne duhet t'i inkurajojmë institucionet e ndryshme në Kosovë e Shqipëri që të hartojnë projekte të përbashkëta në mënyrë që të përfitojnë nga financimet n ndërkombëtare siç është BE e kështu me radhë, është

edhe projekti tjetër, i dyti me radhë në fushën e gjeoshkencave, që është projekt për hulumtimin e kromit në zonën ndërkufitare Kosovë – Shqipëri.

Nga Kosova për këtë projekt është bartës Shërbimi Gjeologjik i Kosovës. Sfera e gjeoshkencave e ka një bashkëpunim të mirë, mund të them, Kosovë-Shqipëri. Në Kosovë ka qenë para pak ditësh për vizitë Agjencioni Kombëtar për Burime Natyrore dhe ambasadori i Shqipërisë në Kosovë zoti Minxhozi është duke mbajtur takime të rëndësishme në këtë drejtim me institucione të ndryshme, sikur me Komisionin e Pavarur për Miniera, Shërbimin Gjeologjik, Ministrinë e Ambientit, sikur që e përmendi më herët edhe deputeti në fjalë.

Është arritur pajtueshmëri që të hulumtohen mënyra për zhvillim të projekteve të përbashkëta të dy shteteve në lëmin e gjeologjisë dhe minierave dhe ky segment ka këmbyer edhe përvoja të ndryshme, sepse siç e dimë Republika e Shqipërisë është shumë e zhvilluar dhe ka përvoja shumë më të mëdha se sa ne në miniera dhe gjeologji.

U përmend nga zoti Ruli apo dikush tjetër, nga deputetët, se jemi ekonomi të vogla investuese që është shumë e vërtet, prandaj ne edhe duhet të fokusohemi në ekonomi të vogla dhe të dy shtetet duhet të rrethojnë projekte nga jashtë dhe konceptojmë projektet e përbashkëta.

Ne kemi edhe mekanizma rajonal e regjional të cilët Kosova dhe Shqipëria, të dyja janë pjesë të atyre mekanizmave, është Komuniteti i Energjisë që udhëheqëse e radhës është Kosova, nëse nuk gaboj, për gjashtëmujorin e parë dhe në kohën kur ka qenë Shqipëria apo një anëtare e Shqipërisë, pjesë e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë ajo ka bërë një punë jashtëzakonisht të madhe që t'i ndihmojë Kosovës të kyçet në këta mekanizma ndërkombëtar dhe t'i ofrojë të kyçet në projekte që kanë të bëjnë në këtë fushë.

Edhe një herë unë ju falënderoj dhe besoj që pajtohemi të gjithë që ne së pari si ligjvënës duhet të bëjmë unifikimin e ligjeve aty ku është e mundur sepse të dy shtetet jemi të interesuara, dhe përveç interesimit, pra kemi edhe obligim t'i harmonizojmë të gjitha ligjet dhe strategjitë me standarde të Bashkimit Evropian, natyrisht aty ku është e mundur, duke iu përshtatur në mënyrë të pacenueshme rrethanave të secilit vend veç e veç. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Urdhëroni tani ju zotëri Dashi!

**KOZMA DASHI...** Faleminderit zoti kryetar, të dyve bashkë, për pritjen e ngrohtë! Ideja është që të gjithë ne, besoj do të donim jo gota, por e gjithë shishja të ishte plotë, por nuk më rezulton kështu. Ç'do me thënë, me qenë më konkret.

Për mua është shqetësuese niveli i bilanceve, është shqetësuese kjo ... aromë, në kurriz, të thuhej, të Kosovës, e po kështu edhe pariteti për shkëmbimin e turistëve.

Atëherë, për të qenë më konkret, mendoj se duhet të jemi ... tog, që edhe këto takime mos të bëhen pjesë e njëfarë mënyre pak mezhorative, do të thosha, duhet të jenë më frytdhënëse dhe të rezultojë diçka. Dhe mendoj se konvergjenca ose shumatorja e tyre, e kena diskutuar, mëse pasi do prodhojë diçka që ia vlen. Pra, do të jemi më konkret.

Mendoj që tëra ato që i thamë ne, shumatorja e tyre përbën esencën e asaj se çfarë duhet të bëjmë neve si ligjvënës – ligjbërës dhe qeveritë tona, por duhet patjetër ta shtyjme këtë problem përpara. Sa për ato që është e drejta që vijnë shumë kosovarë por mos harroni se shumë shqiptarë patjetër që e kanë pjesë të tyre Kosovën dhe shkollat e të tërë tjerat.

Unë do ngrija vartësen e bashkëpunimit, e kam ngritur edhe në Parlament, ideja e këtyre hapësirave të përbashkëta. Konkretisht e kam fjalën për turizmin e Alpeve shqiptare, vetëm duke i konceptuar si një të tërë, të pandarë dhe duke investuar në gjithë këtë zonë atëherë mund të arrijmë të nxjerrim produkte të qenësishme.

Po kështu them dipozitive, përveç këtyre që thashë deri tani, për ta zbukuruar pak, bashkëpunimin në fushën e regjisë, për mua është shumë pozitive. Por duhet vazhduar dhe duhet me laps në dorë që lekët që hidhen nga të dy shtetet të jemi shumë, shumë më domendshëm, dhe ato lekë që i marrim në mënyrë që në studimin e fizibilitetit të jemi jashtëzakonisht sepse nuk e kemi luksin që të harxhojmë pare të tepërta. Sepse mund të na thuhet – duhet bërë ky projekt i madh, dhe sidomos projektet e mëdha duhet të kenë bashkëpunim të jashtëzakonshëm me njëri-tjetrin dhe kur kemi bindje ato pare të harxhohen tamam si duhet dhe të nxjerrin frutat e tyre.

Mendoj se kjo patjetër që do të vazhdojë. E kemi detyrim, e kemi obligim, duhet ta bëjmë patjetër këtë bashkëpunim. Dhe atë që e tha edhe kolegu Besnik, që thotë ndihem si në shtëpinë time, po edhe unë ndihem si në shtëpinë time, sepse këtu e 40 vjet inxhinier u caktova në Malësinë e Gjakovës në Fierz, ku punova 7 vjet dhe mase u hapa kohë, për një i moshuar në atë kohë, tha ne e kemi këtë s'e kuptojmë nga gjuha. I tha njëri matan, prej së poshtmi. I thashë unë – po ti mixh, ti nga je? Unë jam nga mjedisit ore ti. Do të thotë, i thoshte sikur në atë kohën e socializmit që ka po kaq në Shqipëri. Pra, të tërë ne jemi të edukuar e të mësuar me këtë gjë, prandaj t'i shërbejmë kësaj ideje. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit shumë! Po propozoj që t'i japim fjalën kolegut tim Shalsi që të përmbyllë me disa pika të përbashkëta, në të cilat do të punojmë bashkërisht por paraprakisht po ju falënderoj shumë të gjithëve për kontributin tuaj. Ne mendoj se do të kemi kohë, sepse mysafirët kanë udhëtuar, dhe e shtyjme drekën goxha. Vazhdomë!

**EDUARD SHALSI:** Besniku thotë se ne të shkencave ekzakte jemi të prirë më shumë për pjesën konkrete të gjërave.

Unë kam mbajtur shënim disa gjëra, në fakt dhe nuk pretendoj që ne si komisione të zgjidhim të gjithë problematikën e manifestuar, pavarësisht se po i shoh shifrat dhe 2005 – 2015, 5 milionë, kanë shkuar 40 milionë, ndërkohë që 2005 – 2015 18 milionë kanë shkuar 151 milionë. Sigurisht mund të jenë në nivelin e mundësive dhe jam i bindur që duhet të jenë më shumë, por progres ka goxha.

Tani çfarë mund të bëjnë dy komisionet, dhe këtu do të ndalem, pastaj në qoftë se shtohet ndonjë pikë ta shtojmë, por unë kam mbajtur 4 shënime. Kam vë edhe një shtesë për dhomat e tregtisë.



Pra, e para është shkëmbimi i kalendarit të punimeve, për të parë pastaj nëse ka nevojë komisioni apo anëtarët e komisionit për të marrë informacion për, të themi, ligjin e minierave apo ligjeve të veçanta.

E dyta. Marrëveshjet qeveritare ne duhet t'i kemi të depozituara në komision. Ju dhe ne, marrëveshjet dihen, por të zërthehen dhe punonjësit tanë më thonë – Ministria iks, ka marrë përsipër një, dy, tre .... Dhe pastaj marrin vesh, të themi, kjo marrëveshje sepse janë ekzekutive ata që marrin përsipër, dhe dakord ne marrim përsipër të monitorojmë, prezantojmë dhe të kërkojmë llogari. Kjo është e jona. Nuk mund ta bëjmë ne...

E treta. Janë projektet e përbashkëta. U tha, abetarja, rruga, interkoneksioni, tregu energjetik, çfarë mundësisht kanë për projekte të përbashkëta? Dhe ka ndonjë ide të cilat janë projektet e përbashkëta të ardhshme. E përmendi zoti Dashi, unë kam shënim, ka filluar të planifikohet pjesa e Alpeve si një paketë dhe Ministria e Zhvillimit Urban në Shqipëri, nuk e di si quhet këtu, janë duke bërë një projekt të përbashkët, apo të themi një plan të përbashkët, pastaj implementimi është hapi i dytë. Dakord! Por, të paktën ka filluar të hidhet.

E katërta, është çështja e problematikave. Çështjen e problematikave duhet ta bëjmë pak më të formalizuar, të themi, për ato çështjet, pasi të kalojnë dhe të ndahen se çfarë janë çështjet për ndryshime ligjore, çfarë janë çështje burokratike, çfarë janë çështje të themi keqsjellje të punonjësve të administratës. E dimë që kemi probleme me administratën publike, është një problem i vazhdueshëm, jo vetëm në Shqipëri e Kosovë por kudo, dhe si ta reformojmë, është gjë tjetër, ama duhet të themi 1, 2, 3. Pra, cilat janë institucionet, është të themi iksi. Ypsilon i zgjidh tjerat.

Çfarë ka problem? Ka problem me stafin e ... apo ka problem me interpretimin e ligjeve, apo çfarë probleme ka. Pika e katërt. Dhe një nënpikë të cilën unë e kam shënuar e pastaj do ta diskutojmë, është – dhomat e tregtisë, dhomat e biznesit.

Ne, na e ktheu presidenti fatkeqësisht, por shpresojmë ta miratojmë prapë, ne jemi të vendosur për anëtarësimin e detyrueshëm. Ne si Komision kemi problem kur duam të konsultohemi me grupe të interesit, sepse na vijnë dy-tre kryetarë shoqatës, e ndërkohë ne jemi të interesuar të konsultojmë të gjithë sektorin, e ajo që vjen është vjen kryetari, dy nënkryetarë flasin për veten e tyre, kapin çka të kapin, asgjë tjetër. Në ndërkohë, duke vendosur anëtarësimin e detyrueshëm, ne duhet tu japim mundësi dhomave të tregtisë në bazë të modelit austriak dhe gjerman që të vijë ai atje, mos të flas në emrin e vet, por të flet në emrin e ... Te pjesa e dhomave, kam përshtypjen që me ndryshimet dhe fuqizimin e Dhomës së Tregtisë së Shqipërisë, nuk e di si e emëroni ju këtu, nuk e di sa të organizuar jeni, por janë mekanizima të cilët në rast se funksionojnë mund ta lehtësojnë jashtëzakonisht shumë punën e qeverisë. Madje po ju them dhe nuk fsheh se ka dhoma që funksionojnë më mirë se sa ministritë e veçanta, jashtë Shqipërisë.

Kjo ishte një arsye pse ne vendosëm që ta bëjmë.

Pra, këto janë katër fushat, bashkë me këtë të Dhomës së Tregtisë, që e lash si një aneks, të cilat ne duhet t'i formalizojmë në mënyrën e bashkëpunimit. Thashë nuk e zëvendëson dot qeverinë, dakord, nuk e zëvendësojmë dot. Thjeshtë monitorojmë dhe mund ta nxisim. Kur flasim për projekte të përbashkëta themi çfarë ka projekte të përbashkëta dhe çfarë duhet iniciuar. Ajo që ne mund të bëjmë është të kërkohet llogari dhe të thuhet. Këtë e kisha unë. Dhe, dua të falënderohem edhe për pritjen, mikpritjen.

**KRYETARI:** Faleminderit!

Ne këto do t'i formulojmë dhe do t'i kemi si një lloj deklarate të përbashkët dhe marrëveshje për punën e mëtejme. Vazhdojmë pas drekte diskutimin. Ju faleminderit të gjithëve.